



Konkurs i hapur per studentet e arkitektures ne kuader te Energy Expo & Forum 2017, 14-16 Nentor, Expocity Albania

Energy Expo & Forum ne datat **14-16 Nentor 2017** ne bashkepunim me Ministrine e Infrastruktres dhe Energjise dhe me Bashkine e Tiranës. Ky organizim do te kete nje fokus te veçante ne Energjine e Rinovueshme dhe ne Eficencen e Energjise, ku te gjithë aktoret e tregut te energjise elektrike do te paraqesin produktet dhe shërbimet e tyre.

Forumet Ekonomike do te trajtojne gjendjen aktuale te tregut te energjise duke perfshire: legjislacionin e ri, mundesite e financimeve dhe investimeve ne fushen e energjise se rinovueshme si dhe eficencen e energjise. Ky panair ka marre nje rendesi dhe vemendje te madhe, duke marre parasysh problematikat qe ka ky sektor aktualisht ne Shqiperi.

Panairi ***Energy Expo & Forum***, do te permbaje workshop interaktive, prezantime etj.

Ne kuader te ketij organizimi do te organizohet nje konkurs midis studenteve te arkitektures per Eficencen e Energjise, per “Paraqitjen e nje projekti te nje ndertese me zero karbon ose me karbon te ulet. Ndertesa mund te jete publike ose private ekzistuese ose projekt ide. Duhet te vertetohet nepermjet nje raporti te shkurte tegues ose nepermjet llogaritjeve se sa eficiente eshte ndertesa sipas kerkesave te ligjit 116/2016 per performancen e energjise ne ndertesa”

Qellimi i ketij konkursi eshte promovimi dhe inkurajimi i ndertimeve eficiente promovimi dhe fuqizimi i eficiency energjetike, ndërtimit të planeve urbane dhe zhvillimeve lokale.

Hyrje

Ne kuader te ketij konkursi jemi duke kerkuar zgjidhje innovative qe mund te aplikohen ne ndertesa te reja apo ne rinovimin e atyre ekzistuese ne menyre te qendrueshme. Këto dizajne duhet të përbëjnë modelin për ndërtesën e re dhe ndoshta rinovimin e atyre ekzistuese në mënyrë të qëndrueshme.

1. Kriteret e kualifikimit dhe pjesëmarrja në konkurs

Pjesemarrja eshte e hapur per te gjithë studentet e arkitektures me njohuri ne arkitekture ose fusha te tjera relevante. Organizimi do te jete me grupe pune me jo me pak se 3 persona dhe jo me shume se 6 persona. Secili grup pune mund te paraqese vetem nje propozim per cdo ndertese.

2. Koncept- ide (Kerkesat)

Mund te zgjidhet:

- Shkolle publike ose private
 - Ndertese tjeter e njohur
 - Ndertese e re
-
- Pamja e jashtme - Propozimi per ndertesat ekzistuese duhet te jete per fasadat dhe catite i pershtatshem me arkitekturen e vete ndertesës dhe vendodhjes se saj. Per nje ndertese te re te mendohet nje vendodhje gjeografike ne nje zone te caktuar dhe te percaktohet cfare ndertese do te jete (shkolle, spital, ndertese biznesi, banese private etj)
 - Funkcionaliteti - Ne rast se punohet per nje ndertese ekzistuese te jete funksionale ne propozimin e ri njesoj si me pare ose ne permiresim. Ne rast te nje propozimi te ri te jete funksionale sipas destinacionit final te ndertesës.
 - Struktura - Duhet te jete nje propozim strukture i pershtatshem ne rastin e nje ndertese ekzistuese me rrethinat dhe per nje ndertese te re sipas zones dhe qellimit per te cilin do te ndertohet.
 - Materialet - Materialet qe do te perdoren duhet te jene materiale qe mund te gjenden ne territorin shqiptar por edhe te eksportuara, materiale innovative.
 - Mjedisi – Koncept ideja duhet te permbushë kerkesat dhe detyrimet mjedisore ne respekt te ambientit dhe me theksin tek kursimi i energjise.

3. Formati

Cdo grup pune duhet te paraqise vetem nje project. Ne pdf, A3 format, ne forme elektronike dhe hard copy e duhet te permbaje:

- Planet e vendosjes së objektit me dimensione gabarite;
- Plani i organizimit te katit(eve);
- Fasadat;
- Seksionet teknike që specifikojnë materialet e karakteristikat termike;
- imazhe 3D;
- Specifikime teknike (format A4) i cili duhet të përmbajë: specifikimet dhe materialet arkitektonike të nevojshme, konkluzionet, rekomandimet dhe pritjet e koncept-ideve.
- Max 4 vizatime (formati A0) ku te paraqitet i gjithë propozimi.
- Duhet te vertetohet gjithashtu me nje llogaritje te shkurter sa eficiente eshte ndertesa sipas kerkesave te ligjit 116/2016 per performancen e energjise ne ndertesa”

Gjuha e perdorur mund te jete shqip/anglisht. Aplikantet duhet te paraqesin idene dhe zgjidhjen e tyre jo me vone se 14 nentor 2017.

Per te aplikuar ju lutem dergoni propozimet ne (PDF) tek info@expocity.al

Per informacione te metejshme, ju lutem dergoni nje email tek: info@expocity.al

Afati perfundimtar: 14 Nentor 2017.

4. Cmimet

Paneli i jurise do te perzgjedhe dy fitues per projektet.

Cmimi i pare do te zgjidhet ne baze te idese arkitektureore dhe zgjidhjes se paraqitur ne teresi me eficience te energjise.

Cmimi i dyte do te zgjidhet nga pikepamja inxhinierike per te perzgjedhur grupin e punes qe ka dhene zgjidhjen inxhinierike me te mire per eficiencen e energjise.

Cmimi i pare do te marre 500-euro dhe cmimi i dyte nje internship ne nje nga shoqerite e ndertimeve qe ndertojne ne menyre eficiente ne Tirane. Punimet e tjera qe do te vleresohen do te ekspozohen ne Panairin e ardhshem te arsimit te larte qe do te organizohet ne 2018 ne Expocity.